
Gëzim Ajgeraj

BOSI LEPURUSHI

FABULA

BOSI LEPURUSH

Bosi lepurush
Vishet si zotëri
E ka një të metë
Në jetën e tij
Thotë kam pasuri
Prandaj më quajnë Bos
Por shpesh xhaxhi Tomorit
Ia vjedh lakrat në kopsht
Dhe xhaxhi Tomori
Benë ia pat bërë
Do ta ruajë çdo ditë
Të gjallë për ta zërë
Në një mëngjes herët
Për pak nuk e kapën
Ikës lepurushi
Në ferra e shqeu pallton
Qeshën me të shokët
Për rrobat e shqyera
Bosit lepurushi
I humbi fytyra
Nga ajo ditë bos
Në ferra jeton
Askush nga shokët
Nuk e respekton.

Zvicër, 26.7.2000

GJYQATAR LEPURUSHI

Për gjyqtar e kanë një lepur
ta gjykojë lëndën dhëlpër
ka ngritur gjeli padinë
për çdo natë i prish qetësinë
në kotec përherë i shkon
nga një pulë i mungon
unë fajësinë tha s'e pranoj
lepurit dhëmbët ia tregoj
s'është fajtore zonja dhëlpër
gënjën gjeli si çdoherë tjetër
kështu seanca përfundoi
dhëlpërën gjyqi e liroi

15.4.2001

MBRETI KARKALEC

T'i pushtoni male, lëndina e fusha
do të shpallim luftë edhe për arusha
Sa për zogj pula dhelpra e derra
S'do t'u lëmë vend edhe nëpër ferra
E sa për luanë mos e keni dert
e keni këtu mbretin karkalec
Pastaj do ta shpallim perandorin tanë
Livadhe e fusha ne do t'i sundojmë

14. 8. 2001

KRYETARI I PYLLIT

E zgjodhën në pyll për kryetar
këtë herë një gomar
Punën përpara do ta çojë
kështu dhelpra do të propozojë
Kështu u bë e u dha fjalë
mbeti gomari kryetar
Ndodhën atë vit shumë hajni
kryetari thotë s'e di
Pulat e lepujt u ankuan
se shumë shokë u munguan
Punët e pyllit mbrapsht po vejnë
edhe lisat të gjithë ia prenë
Dhe bilbilat u hidhëruan
kryetarin e shkarkuan
E zgjodhën një pylltar
është më i miri kryetar

3 mars 2001

ARUSHKA E MILINGONA

Një arushkë lëkurë larush
me milingonën u zu në fushë
Sa shumë ajo u hidhërua
grumbullit arushka kur iu afrua
milingonë e sheh sa je
të ha ty me gjithë dhe
dhe nuk priti më aspak
e gëlltiti në stomak
milingonat u tërbuan
në stomak luftën filluan
mori arushka fushës vrapin
o kuku sa më dhemb barku
ra për tokë, volli arushka
milingona keq e sëmuri
milingona fushës shkoi
luftën me arushkën e fitoi

3. 6. 2001

MIS PYLLI

Dhelpra deshi të propozojë
mis pylli të organizojë
në juri tha lërmëni mua
dhe shumica u pajtua
pula, ujkonja e një lepurush
derri, breshka, iriqi e një arushë
këtë herë unë mendoj
mis pylli pula do të fitojë
kështu dhelpra dha mendimin
pulës kuqe i dha shpërblimin
Arushka hilen e kuptoi
grushte e shqelma e sulmoi
u prish gara kush s'fitoi
dhelpra iku pyllit shkoi

3. 6. 2001

HAJDUTI I MJALTIT

Kush i hëngri bletës mjaltin
nuk e mori askush fajin
unë tha lepuri nuk e di
ndoshta e di zoti ari
unë tha qeni e kam parë
ariun nga koshi duke dalë
kot tha mua më fajësoni
diku tjetër fajin kërkoni
mbeti hajni një enigmë
unë tha bleta do ta zgjidh
disa ditë sa kaluan
ariu tha tashmë harruan
pranë koshit e zbuluan
kokë e bark kudo e shpuan
kështu ariun e dënuan
buçko fytyrën ia punuan

3. 6. 2001

DY HAJDUTËT

Se arushka e mban fajësinë
e dëshmoi lepurushi drejtësinë
I vuri syrin arushës
tek po hante lakra fushës
kur po hyja tha unë te kopshti
ti po haje mjaltë te koshi
të dy u grindën e u hidhëruan
njëri tjetrin e zbuluan

15. 4. 2001

KËMBË TË SHKURTA KA HAJDUTI

I thanë krimbit kush e hëngri mollën
unë nuk di, kam gojë të vogël
ndoshta mollën e hëngri zogu
kur po e ndiqte një ditë maçoku
apo pula një ditë tjetër
kur po e ndiqte zonja dhelpër
sa për pulën unë betohem
pyeteni qenin ai s'hetohet
bishti në tela dhelprës i mbeti
kur e zunë te koteci
dhe maçokun e qortojnë
përse zogun e shqetëson
edhe krimbit i vunë rojë
dhe e zunë brenda në mollë
nga ajo ditë asgjë nuk humbi
këmbë të shkurta ka hajduti

Zvicër, 15. 4. 2001

ZGJEDHJET NË PYLL

Zgjedhjet dhelpra organizoi
dhe fushatën e filloi
votoi pula edhe gjeli
për kryetar tha fitoi derri
sa për ty tha zoti ujk
kokrrat tua i hëngri një hut
e për kokrrat e ariut
i hëngrën delet e bariut
kali e lopa u hidhëruan
ata fare nuk votuan
sa për votën e luanit
e pavlefshme tha komisioni
për iriqin e zonjën breshkë
raundin e dytë do ta arrijnë në vjeshtë
Për gomarin s'ka rëndësi
ka ngelur në baltë inatit të tij
Kështu zgjedhjet përfunduan
asamblenë e themeluan
Nga ajo ditë në pyll e në fushë
zonjës dhelpra s'ia prish askush

8. 7. 2001

LEPURUSHI BUDALLA

Nga aeroplani një lepurush
Po shikonte poshtë në fushë
Retë si borë kur i pa
Të kërcejë, hopa tha
Hop kërceu përmbi re
Do më mbajë kjo borë e re
Treti qiellit poshtë në fushë
U bë copë ky lepurush

KUVENDARJA DHELPËR

Me dredhi kjo lajkatare
erdhi u bë kuvendare
i prin pyllit plot dredhi
i ka vënë punët në vijë
ku është gjeli më i madh
me tender për vete ndan
ju të gjithë më keni zgjedhur
merr do kocka ua hedh
ka ankesa në kryesi
për zonjën dhelpër plot dredhi
një nga një i shikon
nuk qan kokë as s' mendon
mblidhet pylli e proteston
zonjës dhelpër s'ia dëgjon
i ka vënë punët në vijë
ka mbështetjen në kryesi
sa për tjerët ha-ha-ha
lum për vete mirë e ka.

Prizren, 15.4.2004

ZOGU DHE KFAZI

Pa më thuaj ti kafaz
Ti a unë do të plas
Kështu brenda s`shkon kjo verë
Ty të plastë ajo derë
Unë s`mund të rroj pa ty
Prandaj unë të mbaj në dry
Po mos të ishte kënga jote
Do të më brenin këto mote
Ciu ciu t'u kalbtë dera
E për mua të vijë pranvera
Hekurat e tu t'u korozofshin
Nëmët e mia të mbulofshin
Mbylle gojën mos shkreto
Edhe mua mos më hidhëro
Se përndryshe të dënoj prapë
Për të ngrënë nuk të jap
Ç` të kam bërë as vet s'e di
Kënga ime do liri
Sado mua mbyllur më mban
Këngën time s'e ndalon
Por një ditë nga dy duar
Dera hapur ishte harruar
Iku zog u fluturoi
Ndryshku kafazin e mbuloi

Zvicër, 4.12.98

UJKU DHE QENGJI

Qengj o qengj larush
Eja të dalim nëpër fushë
S'të ikën dita në kope
Dil këtej hajde me ne
Më kanë thënë mor zoti ujk
Që përjashta mos të luaj
Por unë pakëz dëshiroj
Nëpër fushë të vrapoj
Morën rrugën fluturim
Qengji rrugës po i prin
E nis ujku po ankohet
Unë u lodha s`më vrapohet
Ulen bashkë afër një ferre
Ankohet ujku gjumin ma nxore
Po të shoh unë në ëndërr
Ç'më shikon ti mua vëngër
Çfarë po flet zoti ujk
Gjatë tërë natës unë fle but
E nga gjumi kënd s'e zgjoj
Dhe as ty kurrë s'të pengoj
Mblidhi këmbët mos fol fjalë
Edhe ëndrrat m'i ke marrë
Dhe më gjatë ujku s'e çoi
Qengjin pa faj e kafshoi.

Zvicër, 4.12.98

LUANI DHE SORRA

Sorrë moj të plastë sqepi
Pse ma prish gjumin ç'të gjeti
E atë glasë ku e gjuajte
Për kokë timen ti e ruajte
Të më falë zoti luan
Fort merak për ty sot jam
Unë e di se ke uri
Thashë të dalim në gjueti
Kam përtësë dua të ç`lodhem
Edhe sot nuk do të zgjohem
Sa për nesër do të shoh
T`lutem glasën ma largo
Sa për glasën menjëherë
Thashë unë lajmin të ta sjell
I kam parë në fushë do dhi
E të dalim në gjueti
He he he moj korba sorrë
ik të lutem m'u largo
lërmë të qetë të them
dhe në gjumë mos më pengo
kua kua kua more luan
unë për vete nuk e kam
thashë për ty se ke uri
mish të majmë ato dy dhi
iku sorra fluturim
u ngjit qiellit me nxitim
kish uri barkthata
e për mish e kish zënë vapa

Zvicër, 4.12.98

KALI DHE GOMARI

Pse gomar aq shumë pëllet
Zërin tënd të gjithë e urrejnë
E dëgjon hingëllimën time
Është i ëmbël s'ka zemërimë
Ti mor kalë me bisht të gjatë
S'ke në kokë fare inat
Të mashtruan me samar
Të ngarkuan edhe barrë
Ndërsa mua s'ma bëjnë atë
Se i ngul këmbët në balt
E s'del kush të më largojë
Derisa mua t`më kalojë
Edhe ty more gomar
Të ngarkuan të vunë samar
Sa për shalë je i shëmtuar
E në dasma krushq s'të duan
Unë në dasma sa herë shkoj
Ke parë ecjen si e ndërroj
Edhe nusen shpesh e bart
Më besojnë se s'mbaj inat
Ndërsa ty more gomar
Trego shpinën e ke varrë
Sa herë të sjellin me hu gardhi
E ti s`ndaresh nga inati
Asnjëherë mendjen s'e ndërroj
Askujt udhën nuk ia lëshoj
Edhe qimen mund ta ndërroj
Por inatin s'e harroj.

Zvicër, 4.12.98.

LEPURI DHE BRESHKA

Ditë e bukur sot moj breshkë
Propozoj të dalim në bjeshkë
Të vrapojmë në pyje e ara
Ne të dy të bëjmë gara
Unë në gara s`mund të vrapoj
As si ti unë nuk lavdërohem
E as lakrat kujt s'ia dëmtoj
E me kënd të armiqësohem
Ha ha ha ç`më bën të qesh
Sa frikohesh ti moj breshkë
As në gara nuk ta mban
Më e shpejtë se ti unë jam
Sa për trim të njoh kush je
Frikacak shoqin s'e ke
Të kujtohet atypari
Si ke ikur nga gjahtari
Këmbët e tua nxirrnin zjarr
Më erdhi keq po çfarë të bëja
Ula kokën në samar
Mbylla sytë nisa të qaj
S`është e vërtetë se jam frikuar
Unë veten e kam provuar
Se sa mundem të vrapoj
Në olimpiadë dua të shkoj
Për shpejtësi të vjen inat
Unë këtë sport e kam zanat
Çdo ushqim unë e shijoj
Dhe kudo unë jetoj

Ha ha ha more derëzi
E sheh pra se s'ke shtëpi
Unë vetë e kam në shpinë
Ku të dua bëj pushim
Kështu veshgjati u hidhërua
Iku se më s'iu durua
E u ngjit pyllit përjetë
Nën një ferrë ai gjeti vend

Zvicër, 8.12.98

QENI DHE MIZA

Lërmë rehat mori mizë
Ndryshe qafën do t'ta gris
Je e lirë e m'u largo
E mërzinë ti mos ma shto
Bju bju miza fluturoi në hava
S'mund të më zësh o qen i tha
Nga zinxhiri s'të ndihmoj
Lërmë pak gjellën ta provoj
E në pjatë të të ndihmoj
Dhe urinë pak ta largoj
Ham ham ham shporru qelbësirë
Të mos isha në zinxhir
Unë ty do ta tregoja
Krahët do t'i copëtoja
Iku miza me nxitim
E mbi bajgë gjeti shpëtim
Kishte etje dhe për krua
Vajti e shkoi në përdua

Zvicër, 4.12.98

DHELPA DHE PULA

Zonja pulë ç'të paska gjetur
Në kotec paske mbetur
Pse nuk del ti nëpër ara
Se ka shumë kokrra e fara
Ko ko ko mori dhelpër
He sa shpejt e gjen gënjeshtren
Sjelljet kush nuk t'i kupton
Çdokënd ti e mashtron
Të betohem të bëj be
Nëpër ara shumë grurë ke
Në fushë është një gjel i tha
Është i bukur me të nuk ka
Ko ko ko ki ki ki
Gjelin e kam për mrekulli
Kur këndon tek oborri
S'ia kalon atij as kori
E kur dal me të në fushë
Ma e ka lakmi gjithkush
Të gjitha shoqet e mia
Pëlçasin nga lakmia
Unë e kam në të mirën tënde
Se përndryshe s`kam nevojë
Më vjen keq si të kanë mbyllur
E unë thashë të të tregoj
Ki ki ki mori dhelpër
S'të besoj se e luan besën
Unë ta njoh dinakërinë
Dhe në dhëmbë e ke tradhtinë
Iku dhelpra me tërbim
N`kotec tjetër me nxitim
E diku ta mashtrojë një pulë
Asaj eshtrat t'ia shkulë

MACJA DHE MIU

Mace moj të raft mustaku
Pse nuk më lë të shkoj te djathi
Të marr pak sa ta provoj
Dhe mandej do të shkoj
Unë te djathi s'të lejoj
Se njeriu ma besoi
Shërrit yt më duhet të rri
Mbyllur brenda në shtëpi
Nuk e di cili më shumë
Unë nga ti a ti nga unë
Mbyllur në birë më burgon
E përjashta nuk më lejon
Mjau-mjau more mi
Më bën dëm nëpër shtëpi
Prandaj ty më duhet të të ruaj
Ndryshe dëmin tënd duhet ta vuaj
Po ma bëre ndonjë dëm
Më qortojnë brenda nuk më lënë
Derisa ty të të copëtoj
E pastaj do të pushoj
Dil lirisht përjashta luaj
Unë nga vendi s'do të luaj
Shko përjashta luaj me top
S'do të marr djathë asnjë copë
Edhe dje ti m'u betove
Por prapë djathin ti ma vodhe
Pastaj mua më dënuan
Edhe drekën ma ndaluan
Dil përjashta të të tregoj
Atë inat që këtu mbaj
E pastaj do të jem e lirë
Do të luaj me dëshirë

Zvicër, 9.12.98

FLUTURA DHE IRIQI

O iriq ç`bën aty
Dil nga ferra tash është verë
Më sheh mua si fluturoj
Lule më lule i kërkoj
Mirë e ke ti moj flutur
Por unë këtu e kam më bukur
Se askush nuk më pengon
Është imja kush nuk më largon
Ti vërtet shkon lule më lule
Por askund ti vend nuk nxë
She aromën shpesh e ndërton
Por shtëpi kund nuk ndërton
Unë vërtet nuk kam shtëpi
Por jam zonjë me bukuri
E as gjembat nuk më shpojnë
Topthat krahëve më zbukurojnë
Mua nuk më duhet bukuri
Por me dorë nuk më kap njeri
Se me gjemba unë e shpoj
Të më prekë kënd s'e duroj
Unë vërtet rrallë dal në fushë
Se këtu nuk më nguc askush
Shumë i qetë këtu jetoj
Dhe në jetë shumë nuk kërkoj
Iku flutura u zemërua
Me iriqin u hidhërua
Ai fare s'e dëgjoi
Dhe lavdi nuk i shkoi

Zvicër, 10.12.98

ARIU DHE BLETA

Të lutem ari
Nga këtu m'u largo
Të vegjlit e mi
Ti mos m'i trazo
Ndryshe do të ndeshemi
Pra mos më hidhëro
Më mirë me të mirë
Nga koshi m'u largo
Ha ha ha ha ha
Ç'po më bën të qesh
E sheh veten sa je
Të bëj li e lesh
Unë do ta marr mjaltin
E s'të pyes fare
Më mirë largohu vetë
Bëri vetes qare
U hidhërua bleta
U ngrit të fluturojë
Më prit tash ari
Se tash unë të tregoj
E sulmoi ariun
S'la vend pa e kafshuar
Të thashë o ari
Më mirë të ishe larguar
Dhe iku ariu
Teposhtë me nxitim
Pranë një ujëvare
Të kërkojë shpëtim.

MBLEDHJE NË PYLLË

Mbledhjen e hapi papagalli
Sot do ta zgjedhim kryetarin
Në propozim kam një kandidat
Është punëtor ka pak inat
Për gomarin unë nuk jam
Ai drejtësi nuk di të ndajë
Për drejtësi ma lini mua
Atë detyrë shumë e dua
Sa fort gjeli u hidhërua
Unë dhelpren nuk e dua
Sa për kalin nuk kam fjalë
Është i mirë punëtor pa fjalë
Mjaft ti mor me atë sqep
Nisi dhelpra po flet rreptë
Mbylle gojën mjaft më dhelpër
Në propozim unë e vë delen
Ndalun pak more ujk
S'ta ka frikën ty askush
Për kryetar vendin e kam
Më i madhi i pyllit jam
Ha ha ha qeshi milingona
Unë fare s'të frikësohem
Unë ariut s'ia jap votën
Është gjumash nuk ec me kohën
Sa për breshkën nuk kam fjalë
Nis dhe lepuri foli një fjalë
Ju të dy ta mbyllni gojën
Se shqiponja na hidhërohet

Unë e vë në propozim
Ky dhe është mendimi im
Ndërsa unë ia mbaj procesin
Të gjithë në hutin nisën të qeshin
Edhe unë e kam një fjalë
Foli miu me ngadalë
Unë jam për zonzjën mizë
Ajo është zonzjë e shtëpisë
Ham ham ham foli qeni
Ju lutem mizën mos ma lini
Më bën nevrrik s`mund ta duroj
Unë pëllumbin e propozoj
Unë do të ndalem prapë te miu
Është dëmtues s'e do njeriu
Foli macja me ngadalë
Edhe për mizën kundër jam
Unë për macen po mendoj
Edhe ndihmë do t'i ofroj
Foli gjarpri përmbi gur
Sa për miun nuk jam kurrë
Fort krimbi po ngushtohet
Në pëllumbin po ankohet
Unë jam për ariun
Ai mirë qëndron me njeriun
Sa fort bleta u hidhërua
Unë ariun tha s'e dua
Sa herë s'jam në shtëpi
ma vjedh mjaltin pa mërzi
Papagalli u drejtohet
Për zëdhënës vetë propozohet

Për konferenca e gazetarë
Di të presë e të zgjedhë fjalë
Zgjati mbledhja rreth dy ditë
S'u pajtuan në asnjë pikë
Në atë mbledhje s`fitoi kultura
Prej aty nisi dhuna

Zvicër, 21.12.98

DHELPRA DHE HUTINI

Ç`bën atje ti more hut
Mua rrugën ma trego
Unë në fshat dua të shkoj
Kam do miq t'i vizitoj
Hu hu hu mori dhelpër
E pabesë po nuk je tjetër
Kam frikë se më mashtron
Si pëllumbit ma punon
Me pëllumbin ka qenë punë tjetër
Me të kishim një zënkë të vjetër
Njëherë pulave u pat treguar
Para se unë të kisha shkuar
Këtu nga lisi unë nuk zbres
Prapë në ty unë nuk kam besë
Por ty rrugën do ta tregoj
Nga këtu unë të drejtoj
Thashë dhe rrugën ta bëjmë bashkë
Kam frikë se është natë
Më shoqëro deri në fshat
Që mandej të kthehemi bashkë
Dhe hutini u mashtrua
Rrugën bashkë e vazhduan
Sa arritën pranë një lumi
Ajo qafën ia këputi

Zvicër, 11.12.98

FESTIVALI NË PYLL

Qenë mbledhur gjithë pylli
Festival të mbajnë
Dhelprën dhe luanin
Për juri e lanë
Nisën një nga një
Radhas të këndojnë
Dhelpra dhe luani
Duhet t'i vlerësojnë
Kënduan një nga një
Kush ashtu siç di
Dikur i erdhi radha
Fjalës për drejtësi
Unë tha luani
Ia jap bilbilit
Ai është më i miri
Këngëtar i pyllit
Unë tha jam për gjelin
Nguli këmbë dhelpra
Kur këndoi ai
M'u rrëqethën leshrat
U prish festivali
U bë tollovi
Luani e rrahu dhelprën
Dhe ndau drejtësi
U hidhërua dhelpra
Iku dhe vrapoi
Por askush mbrapa
Asaj nuk i shkoi.

Zvicër, 22.12.98

NË TREGUN E PYLLIT

Pula pranë një lisi
Ulur shiste vezë
Zogjtë përreth veti
I ruante me kujdes
Pak më poshtë dhia
Qumësht të vetin
Një skaj tjetër lopa
Plotpërplot bulmetin
Vërdallë sillej dhelpra
Vendi nuk e zinte
Ruante ariu
E nuk pat nga të vidhte
Po vjen edhe bleta
I thotë ariut
Por ka mbetur ferrave
E s'po mund të ngjitet
E mashtroi ariun
Dhe hyri në treg
Diku një zog pule
Deshi t'ia vjedhë
Nis të vajtojë pula
Për zogun e vet
Por dhelpra poshtë pyllit
Moti kishte tretur
Vetëm pendlat e zogut
Pranë lumit kishin mbetur

1 janar 1999

SHQIPONJA DHE LEPURI

Kish marrë vrapin lepuri
Këmbët i nxirrnin zjarr
Nдалu pak o lepur
Iriqi tha një fjalë
Nuk foli asnjë fjalë
Vrapin e vazhdoi
Mbi kokë e pat shqiponjën
Dhe nuk pat ku të shkojë
Poshtë në një lëndinë
E zuri nën këmbë
E ngriti lart qiellit
Dhe e plasi mbi shkëmb
Ra pa frymë lepuri
Trupi iu copëtua
Nisi pjesë-pjesë shqiponja
Mishin duke ia grimcuar
E hëngri gjithë lepurin
Dhe lart fluturoi
Pastaj nisi bjeshkës
Të pijë ujë kërkoi

1 janar 99

MBRETËRIA E DHELPRAVE

Në pyllin me lisa u shpall një mbretëri
Dhëpër bishtlaroshja shpalli perandori
Caktoi territore në malin plot lisa
Qytete e katunde, kudo vuri pika
Për mbretërinë e vet bëri dhe kala
Pallat për mbretëreshën që kush nuk e ka
Në katunde e qytete, nga një dhëpër emëroi
Dinakërinë e vet, bukur ua mësoi
Vjedhin këto dhëlpra, s'lënë pula në qytet
Sepse në katunde, lufta i bëri shkret
Mbretëria e tyre kudo ka harbuar
Vaj halli kotecet, kudo kanë shteruar
Mbi planet e ditës, natyrën e rrotullojnë
Nën mbretërinë e tyre, gjithçka e shkretojnë.
Vaj halli për pyllin, fushat po shterojnë
Nën mbretërinë dhëpër, gjithçka po dredhon.

Zvicër, 2000

SHOQËRIA E DHELPRËS

Tregoi dhelpra shumë mjeshtëri
me luanin lidhi shoqëri
e lavdëroi e e lavdëroi
derisa besimin e fitoi
Për fuqi kush s'ia kalon
Më i shkathët zoti luan
S'zgjati shumë nisën dredhitë
rrënjët shoqërisë i dolën në dritë
Sillej dhelpra kah oborri
dhe luanit shumë i vodhi
Por luani nuk mërzitej
Për dredhi dhelprën e njihte
Kur ta zë tha ndonjë ditë
Do t'ia qes të gjitha në dritë
Sa për shoqëri e muhabet
Gjithsecili në vendin e vet.

Zvicër, 2000

Gëzim AJGERAJ, u lind në Malësi të Vërrinit më 6 gusht të vitit 1967. Ka botuar këta libra: **1. "Klithmë malli"**, poezi, „Rilindja”, Prishtinë, 1997; **2. "Ëndrra për parajsë"**, poezi, "Rilindja", Prishtinë, 1998; **3. "Qiellit po digjem"**, poezi, „Rilindja”, Prishtinë, 1998; **4. "Flakë në plagë"**, poezi, „Rilindja”, Prishtinë, 1998; **5. "Kënga e babait"**, poezi për fëmijë, „Apolonia”, Prishtinë, 1998; **6. "Urti popullorë të Vërrinit" 1** (bashkautorësi), „Apolonia”, Prishtinë, 1998; **7. "Mallëngjimi"**, poezi, „Rilindja”, 2000; **8. "Balada e Vërrinit"**, Kl. „F. S. Noli”, Prizren, 2001; **9. "Rruga e lirisë"**, dramë, „Meshari” Prishtinë, 2001; **10. "Rruga e lirisë" - Intervistë me Zafir Berishën**, botoi Asociacioni i Veteranëve të ish-UÇK-së – Prizren, 2002; **11. "Atdheu në trastë"**, cikël me poezi, botoi revista letrare "Jeta e re" nr. 4, korrik-gusht 2002, viti LIV. Prishtinë; **12. "Pëllumbat e lirisë"**, novelë për fëmijë, Edicioni i revistës "Fidani", Prizren, 2004; **13. "Ditët e bardha"**, novelë për fëmijë, Edicioni i revistës "Fidani", Prizren, 2004; **14. "Atdheu i copëtuar"**, cikël me poezi, në librin **"Pikoi molla gjak"** (Lirikë me motive arvanitase), botoi MKRSCJR-Departamenti i Çështjeve Jorezidente, Prishtinë, 2004; **15.** Cikël me poezi **"Udhë e zjarrmi"**, në librin "Muzat i bien Iyrës", Edicioni i revistës "Fidani", Prizren, 2005; **16. "Lulëkuqet e Vërrinit"**, poezi, botoi shtëpia botuese "Metafora", Zvicër, 2005; Ka bashkëpunuar dhe bashkëpunon me të gjitha gazetat dhe revistat e kohës, si: "Rilindja", Zvicër - Prishtinë, "Bujku", Prishtinë, "Zëri i Kosovës", Zvicër - Prishtinë, "Bota sot", Zvicër, "Koha ditore", Prishtinë, "Epoka e re", Prishtinë, "Zëri", Prishtinë, "Fakti", Shkup, "Ars", Tiranë, "Pena shqiptare", Prishtinë, "Pionieri", Prishtinë, "Zogu i mëngjesit", Prishtinë, etj. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës në Prishtinë. Që nga 23 marsi 2002, është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Zvicrës (SSV). Jeton dhe vepron në Zvicër.

Libra të tjerë:

17. Zana në mërgim, poezi për fëmijë, "Metafora", Zvicër, 2006;

18. Huqet e Benit, poezi për fëmijë, "Metafora", Zvicër, 2006;

19. Bosi lepurushi, fabula, "Metafora", Zvicër, 2006;

20. Gjëgjëza, "Metafora", Zvicër, 2006;

21. Dita me Tonin (Poemë), "Metafora", Zvicër, 2006;

22. Muajt e vitit me Ardin (Poemë), "Metafora", Zvicër, 2006;

Që nga janari i vitit 2004, editon revistën **"Metafora"**, *Editorial i poetit që del në çdo tre muaj*.

PËRMBAJTJA:

BOSI LEPURUSH.....	4
GJYQATAR LEPURUSHI.....	6
MBRETI KARKALEC.....	7
KRYETARI I PYLLIT.....	8
ARUSHKA E MILINGONA.....	9
MIS PYLLI.....	10
HAJDUTI I MJALTIT.....	11
DY HAJDUTËT.....	12
KËMBË TË SHKURTA KA HAJDUTI.....	14
ZGJEDHJET NË PYLL.....	15
LEPURUSHI BUDALLA.....	16
KUVENDARJA DHELPËR.....	17
ZOGU DHE KAFAZI.....	19
UJKU DHE QENGJI.....	20
LUANI DHE SORRA.....	21
KALI DHE GOMARI.....	22
LEPURI DHE BRESHKA.....	23
QENI DHE MIZA.....	26
DHELPA DHE PULA.....	27
MACJA DHE MIU.....	28
FLUTURA DHE IRIQI.....	29
ARIU DHE BLETA.....	31
MBLEDHJE NË PYLL.....	32
DHELPA DHE HUTINI.....	35
FESTIVALI NË PYLL.....	37
NË TREGUN E PYLLIT.....	38
SHQIPONJA DHE LEPURI.....	39
MBRETËRIA E DHELPRAVE.....	40
SHOQËRIA E DHELPRËS.....	41
BIOGRAFIA.....	42

Gëzim Ajgeraj

Bosi Iepurushi

Lektor: Ilam Berisha

Ilustrimet: TONI

Radhitja kompjuterike: Ardian dhe Artan Ajgeraj

36 faqe: 20 cm.

Tirazhi: 500

Të drejtat e rezervuara për autorin

GA 19670608-06-19